



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 10095 /2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2016 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIU DHËN KORRIK-SHTATOR PËR VITIN 2016

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e shpenzimeve buxhetore për periudhën Korrik -Shtator për vitin 2016.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Korrik - Shtator 2016 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2016 është në shumë prej 2,066,396.00 €, ndërsa ai përfundimtar është në shumë prej 2,235,489.66 € (duke përfshirë mjetet që janë ndarë me rishikim të buxhetit nga Ministria e Financave në shumë prej 40,000.00 € në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, si dhe bartjen e të hyrave vetanake të vitit të kaluar në shumë prej 129,093.66 €). Në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 1,046,474.17 € apo 76.58%, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 101,793.66 € apo 48.47%, në kategorinë ekonomike shpenzime komunale shpenzimi është në shumë prej 34,884.25 € apo 71.46%, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 35,183.50 € apo 65.71% , në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 261,663.41 € apo 47.01%.Totali i shpenzimit është në shumë prej 1,479,998.99 € apo 118,110.25 € më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Të hyrat vetanake për këtë periudhë nëntëmujore 2016 janë realizuar në shumë prej 200,807.43 € apo 30,224.64 € më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2015.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit

Data: 27.10.2016





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9935/2016

Në bazë të Ligjit Vetëqeverisje Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 11, 40, Ligji për Procedurën Administrative numër Nr.02/L-28 neni 100, 101, Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me numër 020-1215/1 e datës 21.09.2016 për rishqirtimin e vendimit, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2016 merr:

VENDIM
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01.NR.8068/2016

I

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit shfuqizoi vendimin me numër 01/Nr.8068/2016 për këmbimin e pronës i cili ishte miratuar nga kuvendi i komunës me datën 30.08.2016.

II

Shfuqizimi i këtij vendimi vjen si rezultat i shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal se komuna dhe kuvendi i komunës së Hanit të Elezit këtë vendim duhet ta rishqyrtoj apo ta shfuqizoj, sepse nuk është në harmoni me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

III

Ky vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit.

IV

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 27. 10. 2016

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava

